



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA JURIDIKE DHE PËRPUTHSHMËRISË SË STANDARDEVE
SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____. 2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

31.01.2025

Drejtuar: **BOE “DEHA 2010” & “Rroku GUEST” L03425410B / K87921701H**

Fier Vaikan Fshati Vajkan, zona kadastrale nr--3695 numer pasurie nr- 154/4.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JOX

Tipi I Kontratës: **Klasike**

Procedura e prokurimit/lotit: **“E hapur - punë publike - prokurim me mjete elektronike”**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-34125-12-19-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Sistemim asfaltim rruget e Drejtorise se Rajonit Jugor Gjirokaster”**

Fondi limit: 124,686,479.28 (njëqind e njëzet e katër million e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë pike njëzet e tetë) **Lekë pa TVSH**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: **3 muaj**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **20.12.2024**

Publikimet e mëparshme **Data 23 Dhjetor 2024, Nr. 88**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto **X**

Sipas rëndësisë:

Çmimi <input type="checkbox"/>	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe metodologjia <input type="checkbox"/>	pikët 15
Stafi / Organizimi i Kompanisë <input type="checkbox"/>	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social <input type="checkbox"/>	pikët 10
Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit <input type="checkbox"/>	pikët 10

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE "SHKELQIMI 07"

K68121808W

Vlera: **79,999,997.00** (shtatëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

2 BOE “DEHA 2010” & “Rroku GUEST”

L03425410B / K87921701H

Vlera: **83,332,922.50** (tetëdhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind e njëzet e dy presje pesëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **269.25**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

3. “MELA.”

K62320011G

Vlera: **89,829,647.50** (tetëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e njëzet e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë presje pesëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **159.30**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

4. “S I R E T A 2F”

K51501008J

Vlera: **91,111,112.00** (nëntëdhjetë e një milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

5. “Shendelli”

K07924803N

Vlera: **93,571,123.00** (nëntëdhjetë e tre milion e pesëqind e shtatëdhjetë e një mijë e njëqind e njëzet e tre) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **255.30**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

6. BOE “KUPA” & “EVEREST”

K51615512C / J78311921L

Vlera: **93,794,375.00** (nëntëdhjetë e tre milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **238.20**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

7. “COMPANY RIVIERA 2008”

K81716011V

Vlera: **95,382,517.00** (nëntëdhjetë e pesë milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **211.20**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

8. BOE “MF INVEST GROUP” & “MANE/S”

L71830010R / J64103865K

Vlera: **98,685,587.50** (nëntëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë presje pesëdhjetë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

9. BOE “BEQIRI” & “C O L O M B O”

J98624801V/ J82916489E

Vlera: **103,383,675.00** (njëqind e tre milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **219.45**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

10. BOE “A.L-ASFALT” & “LIQENI VII”

K81511508A / K01730502W

Vlera: **106,658,225.00** (njëqind e gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e pesë) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **0**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

11. "LLAZO"

K24218401K

Vlera: **109,719,720.00** (njëqind e nëntë milion e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet) **Lekë pa TVSH.**

Totali i pikëve të marra: **240.00**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "SHKELOIMI 07" sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht;

1.Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës **2.3.5** *Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar, si më poshtë:*

- *1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

- *1 (një) punonjës që disponon certifikatën si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë në kantier"..."*

❖ ***Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.***

Stafi i deklaruar në formularin e vetdeklarimit për përmbushjen e këtij kriteri është i angazhuar në një kontratë tjetër në proces ndërtimi me Autoritetin Kontraktor, konkretisht në objektin: "Ndërtim i nyjes Bërzhitë dhe rrugët lidhëse të autostradës Tiranë-Elbasan me komunën Bërzhitë dhe zonat përreth", kjo në kundërshtim me pikën 2.3.5 ku thuhet; "Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese"

2.Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës **2.3.6** *Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të*

punimeve (Inxhinier Ndërtimi, profili Infrastrukturë e transportit me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

Inxhinieri i deklaruar si drejtues teknik i punimeve për përmbushjen e këtij kriteri është i angazhuar në një kontratë tjetër në proces ndërtimi me Autoritetin Kontraktor, konkretisht në objektin: “Ndërtim i nyjes Bërzhitë dhe rrugët lidhëse të autostradës Tiranë-Elbasan me komunën Bërzhitë dhe zonat përreth”, kjo në kundërshtim me kërkesën që nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

3.Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës **2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet sipas kërkesave të DST...**

- *Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.*

Disa nga makineritë e deklaruara në formularin e vetdeklarimit për përmbushjen e këtij kriteri janë të angazhuara në një kontratë tjetër në proces ndërtimi me Autoritetin Kontraktor, konkretisht në objektin: “Ndërtim i nyjes Bërzhitë dhe rrugët lidhëse të autostradës Tiranë-Elbasan me komunën Bërzhitë dhe zonat përreth”, kjo në kundërshtim me kërkesën ku thuhet; “Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.”

Skualifikohet oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “SIRETA 2F” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht;

Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës **2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet sipas kërkesave të DST...**

- *Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.*

Disa nga makineritë e deklaruara në formularin e vetdeklarimit për përmbushjen e këtij kriteri janë të angazhuara në një kontratë tjetër në proces ndërtimi me Autoritetin Kontraktor, konkretisht në objektin: “Ndërtim rruga kthesa e Berdicës-ura e Bahcallëkut”, kjo në kundërshtim me kërkesën ku thuhet; “Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.”

Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “MF INVEST GROUP & MANE/S” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht;

Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme*

a) punë të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose**

b) punë të ngjashme deri në një kufi, **ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet...**

Bashkimi i operatorëve për kriterin teknik pika 2.3.1 është paraqitur sipas pikës b) “punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet”.

Operatori “MF INVEST GROUP” shpk., sipas kontratës së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë 76.95 % të punimeve. Ky operator nuk e përmbush vlerën për punët e ngjashme sipas përqindjes pjesmarrëse në kontratën e bashkëpunimit 76.95 % të dyfishit të fondit limit (191,892,491 lekë), pasi pjesa kryesore e punëve të paraqitura për përmbushjen e këtij kriteri nuk janë të ngjashme me natyrën e objektit që prokurohet.

Skualifikohet oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “A.L-ASFALT & LIQENI VII” sh.p.k pasi nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të kërkuara në DST , konkretisht;

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.4 *Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:*

- 1 (një) *Inxhinier Ndërtimi*
- 1 (një) *Inxhinier Mjedisi*
- 1 (një) *Inxhinier Topograf / Gjeodet*

-Nuk ka plotësuar Kriteret e Veçanta të Kualifikimit sipas pikës 2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet disponojë punonjës të specializuar/kualifikuar, si më poshtë:*

-1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë **“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”**, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

-1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe

shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Operatori ekonomik “A.L- ASFALT”shpk., për përmbushjen e këtij kriteri është mbështetur në operator tjetër ekonomikë dhe nuk plotëson të gjithë elementët e përcaktuar në nenin 90 “Mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit 285, datë 19.05.2021 pikërisht pikën 2 të këtij neni “Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

-
- *t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.*
-
- ***Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.***

Oparatori ekonomik ”A-L ASFALT” është mbështetur në më shumë se 50 % në një operator tjetër, më konkretisht është mbështetur për plotësimin e plotë të gjithë kriterit, kjo në kundërshtim me nenin e sipërpërmëndur në të cilin citohet qartë se: ***Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.***

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmëndur, informojmë **BOE “DEHA 2010” & “Rroku GUEST”**, me adresë: **Fier Vaikan Fshati Vajkan, zona kadastrale nr--3695 numer pasurie nr- 154/4.**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **83,332,922.50** (tetëdhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind e njëzet e dy presje pesëdhjetë) **Lekë pa TVSH./** totali i pikëve të marra sipas sistemit [269.25], është identifikuar si fitues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gentian Gjyli